

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË “DUKAGJINI GROUP” SH.P.K.**

Sot më datë 3 Shkurt 2022, **Z. Ekrem Lluka**, i biri i Kurtesh Lluka, i datëlindjes 11.10.1959, lindur në Pejë, Kosovë dhe banues në Pejë, Kosovë shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Dukagjini Group**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**Dukagjini Group**” sh.p.k., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm Z. Ekrem Lluka.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Dukagjini Group**” sh.p.k. do të jetë:

Botimi i veprave të ndryshme dhe në veçanti botimin e librave dhe materialeve shkollore dhe universitare, veprave letrare, veprave të ndryshme artistike etj. Botimet do të kenë shpërndarje të gjere brenda dhe jashtë vendit dhe ato do të marrin forma të ndryshme duke filluar nga forma më tradicionale e letrës së shtypur deri në format moderne elektronike. Aktiviteti i shoqërisë nuk do të kufizohet vetëm me zërat e lartpërmendura, por do të përfshijë çdo veprim që do të lidhet me përgatitjen e botimit, reklamën dhe shpërndarjen e veprave të botuara, qofshin ato libra, revista, gazeta apo të tjera, të çfarëdolloj forme të mundshme.

Shitje online të çdo botimi në formë leter dhe elektronike, botime të veprave shkollore dhe letrare për diasporën. Trajnime profesionale të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar dhe universitar, konsulencë, kurse afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e edukimit profesional për specialistë të fushave të ndryshme të mësimdhënies, gjithashtu, shoqëria do të merret me shërbime si organizimin dhe ndërmjetësimin për konferenca, seminare, aktivitete artistike-kulturore.

Ndërtim, shit-blerje të pasurive të paluajtshme. Tregëti, import-eksport dhe çdo lloj aktiviteti tregëtar të lejuar nga ligji.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë **“Dukagjini Group” sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga e Elbasanit, Zona Kadastrale 8160, Pasuria Nr.5/181, Tiranë, Njësia Administrative Nr.2.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“Dukagjini Group” sh.p.k.** është 1 200 000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“Dukagjini Group” sh.p.k.** është **Z. Blerim Muhaxhiri**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“Dukagjini Group” sh.p.k.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm

Ekrem Lluka

